

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
i
FOOTBALL REPUBLIC**

KAPITULLI I

Emri, Forma, Selia, Kohezigjatja

Neni 1

Data e Themelimit dhe Emri

- 1.1. Sot me date 07.08.2024 themelohet nga ortakut/ortakët themelues, sipas legjislativitetit shqiptar, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **FOOTBALL REPUBLIC** (në vijim "Shoqëria"), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk".
- 1.2. Ortaku/Ortakët i/e Shoqërisë ("Ortakët"/"Ortakët") gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë të përfaqësuar në kuotë/a.
- 1.3. Në të gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet të leshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, emri i saj do të ndiqet ose do të shoqërohet nga :
 - fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "shpk".
 - numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) të saj.
 - adresa e regjistruar;
 - pasqyrimi i faktit që shoqëria është në procedurë likuidimi, nëse aplikohet.
 - kapitalin e regjistruar dhe të paguar të Shoqërisë.

Neni 2


Forma Ligjore

- 2.1. Shoqëria është një person juridik shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ("shoqëri me përgjegjësi të kufizuar"), në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji për Shoqëritë Tregtare").

Neni 3

Selia

- 3.1. Në momentin e nënshkrimit të këtij akti, selia e Shoqërisë ndodhet në adresën:
- 3.2 Fshati Barbas, Numer Pasurie 365/43, Zona Kadastrale Nr. 1433, Volumi 3, Faqe 25, Njësia Administrative Petrele, (Tiranë) Shqipëri.



3.3 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjetër te Shqiperise. Shoqeria mund te hape degë te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikës se Shqiperise.

Neni 4
Kohezgjatja

4.1. Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.

KAPITULLI II

Neni 5
Objekti i Shoqerise


5.1. Objekti aktivitetit te Shoqerise eshte kryerja e çdo aktivitet tregtar te lejuar nga legjislacioni Shqiptar, dhe veçanerisht:

Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jete kryerja e cdo aktiviteti tregtar te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrja ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, sic mund te ndryshohet here pas here dhe ne vecanti, por pa u kufizuar ne:

- Bar - Kafe - Restorant.
- Menaxhim dhe administrim i strukturave sportive.
- Menaxher dhe perfaqesues ne lidhjen e kontratave te sportistëve me ekipet perkatese. Konsulence sportive.
- Menaxhim i aktivitetëve te ndryshme sportive. Menaxhim i kurseve periodike per formimin profesional te trajnerëve te futbollit.
- Menaxhim dhe administrim i ekipeve te futbollit. Menaxhim dhe administrim i shkollave dhe akademive te futbollit per femijet dhe te rinje.
- Organizim eventesh.
- Organizim eventesh sportive dhe rekreative. Sherbime lavanterie.
- Shitje blerje uniforma sportive.
- Qiradhenie e fushave dhe strukturave te tjera mbeshetese
- Ndertim
- Hoteleri
- Tregti mallrash me shumice dhe pakice

Gjithashru, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjetër qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperem, qe mund te konsiderohet i nevojshem per ushtrimin e veprimtarise sipas objektit te shoqerise.

Neni 6
Ndryshime



6.1. Shoqëria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne çdo kohe siç parashikohet ne kete Statut.

KAPITULLI III

Kapitali Themeltar; Quotat e Kapitalit Themeltar

Neni 7

Kapitali Themeltar

7.1. Kapitali i Shoqërise eshte ne total **200.000 (dyqindmije) leke** i zoteruar teresisht ne 2 (dy) kuote/a (me tej "Kuota" /"Kuotat")

Neni 8

Ortaku/Ortakët dhe Kuota/Kuotat


8.1. Ne daten e themelimit Shoqëria ka 2 (dy) Ortak te cilet kane nenshkruar dhe zoterojne Kuotat e Shoqërise, si me poshte :

- **Z. Redi Jupi**, shtetas Shqiptar, i biri i Bashkim, lindur në Vlore, më 31.05.1974, banues në Rruga Skenderbej, Pallati 33/2,Shkalla 1, Apartamenti 6, Njesia Nr. 7, Kodi postor 1023, Tirane - Shqiperi mbajtës i dokumentit Karte Identiteti me Nr. 034514434, Nr.personal H40531048U, me dateleshimi dt. 26.07.2019, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme 102.000 (njqind e dy mije) **lekë, që përbën 51 (pesedhete e nje) % të kapitalit të Shoqërisë FOOTBALL REPUBLIC sh.p.k.;**
- **Zj. Vivjan Jupi**, shtetase Shqiptare, e bija e Mentor, lindur në Tirane, më 25.02.1984, banues në Rruga Skenderbej, Pallati 33/2,Shkalla 1, Apartamenti 6, Njesia Nr. 7, Kodi postor 1023, Tirane - Shqiperi mbajtëse e dokumentit Karte Identiteti me Nr. 034514463, Nr.personal I45225061T, me dateleshimi dt. 26.07.2019, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme 98.000 (nentedhjetemije) **lekë, që përbën 49 (dyzet e nente) % të kapitalit të Shoqërisë FOOTBALL REPUBLIC sh.p.k.;**

Neni 9

Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

9.1. Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te deyrueshme te Ligjit per Shoqërite.



9.3 Rritja e kapitalit do të behet me leshimin e kuota të reja apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit themeltar do të nenshkruhen dhe vlera e tyre do të paguhet plotësisht.

9.4. Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuotë të saj. Megjithatë me qëllim zvogelimit të kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogelimit të kapitalit, Ortakët mund të autorizojnë Administratorin/ret të bëjnë blerjen e kuotave përkatëse apo pjesë të tyre dhe të anulojnë ato.

Neni 10

Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

10.1. Ortaket janë vetëm ata të cilët zoterojnë kuota në Shoqëri.

10.2. Çdo Ortak do të ketë të dehta votë në përputhje me përqindjen e kontributit të zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë dhe që përfaqësohet nga Kuota e tij ose pjesë e Kuotes së tij. Çdo Ortak ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky Statut, dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Shoqëritë.

10.3. Ortake do t'i jepen, pas kërkesës me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentat dhe raportet e Shoqërisë.

10.4. Te drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotes/rave, transferohen tek çdo zotëruar i ri për keto Kuota.

10.5. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaku mban përgjegjësi brenda limitit të vlerës së Kuotes që zotëron. Ortaku nuk mban përgjegjësi mbi vlerën e investimit të tij në kapitalin e Shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata lëshojnë).

10.6. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortakeve të tij.


KREU IV

Asambleja e Ortakeve/Ortaku i Vetëm

Neni 11 Kompetencat

11.1. Asambleja/Ortaku i Vetëm është organi i vendimit më të lartë i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikën e saj ekonomike dhe tregtare.



Neni 12 Mbledhja



- 12.1. Asambleja/Ortaku i Vetem duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.
12. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkeshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- 12.3. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjitha aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja/Ortaku i Vetem do te vendose mbi bazen e raportit te eksperitit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet, pervec rastit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- 12.4. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga ortaku pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 12.5. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja/Ortaku te Vetem i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- 12.6. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja/Ortaku i Vetem mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e Administratoreve.

Neni 13 Menyra e Thirrjes

- 13.1. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara tij nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.
- 13.2. Asambleja/Ortaku i Vetem mund te mblidhet nga nje prej Administratoreve ose me iniciativen e tij.
- 13.3. Asambleja/Ortaku i Verem mblidhet ne seline e Shoqerise, ose ne ambientet e deges se Shoqerise apo ne cdo qytet, province apo shtet tjeter, siç bihet dakord nga Asambleja/Ortaku. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dities perketes i mbledhjeve i njoftohet Ortaku/Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes, se bashku me dokumentat e nevojshme te lidhura me ceshtjet e rendit te dities. Ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem nuk eshte mbledhur/thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem eshte dakort.
- 13.4. Ortaku gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.



13.5. Ortaku ka te drejten te votoje ne perputhje me vleren e Kuotes se zoteruar prej tij ne kapital.

13.6. Vendimet e meposhtme do te merren me nje kuorum prej me shume se 1/2 e kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterrojne te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje:

- vendimet ne lidhje me mos shperndajten e fitimeve apo/dhe me destinacionin e ndrshem te fitimeve te Shoqerise;
- ndryshimi i Statutit;
- likuidim ose riorganizmin e Shoqerise;
- zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise;

Çdo vendim tjetër do te merret me nje kuorum prej me shume se 30% te kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterrojne 51% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje.

13.7. Ortaku/Ortaket do te njofrohen per permbajtjen e axhendes se mbledhjes.

13.8. Administratori/ret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ljgjit per Shoqerite dhe do te regjistrojne te gjitha vendimet e marra ne Regjistrin e Vendimeve.

Neni 14

Perjashtimi nga e drejta e votes



14.1. Nje Ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur eshte duke vendosur mbi:

- vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- dhentien ose jo te perfitimeve te reja.

14.2. Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

KREU V Administratori/ret

Neni 15 Administratoreve dhe kompetencat



15.1. Shoqëria mund të administrohet nga një ose me shumë Administrator/re, sipas vendimit të Asamblese/Ortakut të Vetem. Administratori/ret mund të jetë i çdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jetë rezident në Shqipëri.

15.2. Në momentin dhe për qëllimin e miratimit të këtij statuti administrator i Shoqërisë është:

- **Z. Redi Jupi**, shtetas Shqiptar, i biri i Bashkim, lindur në Vlorë, më 31.05.1974, banues në Rruga Skenderbej, Pallati 33/2, Shkalla 1, Apartamenti 6, Njësia Nr. 7, Kodi postor 1023, Tiranë - Shqipëri mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me Nr. 034514434, Nr.personal H40531048U, me datë lëshimi dt. 26.07.2019, i cili cmërohet për një periudhë prej 5 (pese) vjetësh, nga data e themelimit të Shoqërisë, të percaktuar në këtë dokument. Çdo ndryshim i mëposhëm në lidhje me emerimin e Administratorit/reve nuk do të konsiderohet si një ndryshim Statuti.

15.3. Administratori/ret emerohen për një periudhë prej 5 (pese) vjetësh, të rinovueshme. Në rast të me shumë se një Administratori kompetencat që do të ushtrohen vecmas nga secili prej Administratorëve, nëse ky është rasti, do të percaktohen në vendimin e Asamblese/Ortakut të Vetem që emeron Administratorët.

15.4. Menjëherë pas pranimit të emerimit të tij/tyre, Administratori(et) njohin në se marrdhenia e tyre me Shoqërinë ndërtohet mbi baza mirebesimi; lidhur me këtë vendim për heqjen e tyre nëpërmjet një vendimi të Asamblese/Ortakut të Vetem gjykohej si arsye e ligjshme për shkakimin e tyre nga puna, në përputhje me ligjet përkatëse.

15.5. Asambleja/Ortaku i Vetem ka të drejtë të shkaktojë Administratorin(ret) në çdo moment.

15.6. Nëse Administratorët e Shoqërisë nuk arrijnë të bien në një mendim të përbashkët lidhur me mbylljen, përfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve të tjera, çështja do të referohet tek Asambleja/Ortaku i Vetem.


15.7. Për atë që është e lejueshme dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar ose me çdo legjislacion iku aktet e Administratorit(ëve) kanë fuqi vepruese, Administratori(et) kanë të drejtën të marrin vendime në lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present në Shqipëri ose në ambientet e Shoqërisë. Shoqëria mund t'u rimbursojë Administratorit(ëve) shpenzimet e arsyeshme gjatë udhëtimeve lidhur me prezencën e detyrueshme të Administratorit(ëve) në vende që nuk janë brenda qytetit të residences së Administratorit(ëve).

Neni 16

Kompetencat dhe detyrimet e Administratorit/reve

16.1. Kompetencat e Administratorit në kuadër të përfaqësimit të Shoqërisë përfshijnë:

- (i) kërkesa/thirrjea e mbledhjes së Asamblese/ Ortakut të Vetem, në rastet e specifikuara në nenin 13;



- (ii) menaxhimin e aktivitetit të përditshëm tregtar të Shoqërisë nepërmjet implementimit të politikave dhe planeve të përcaktuara nga Asambleja/Ortaku i Vetëm;
 - (iii) përfaqesimin e Shoqërisë me palet e treta;
 - (iv) kujdesin për mbajtjen në mënyrë të përshtatshme të dokumentave dhe librave kontabel të Shoqërisë;
 - (v) përgatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve që i paraqiten për miratim tek Asambleja/Ortaku i Vetëm;
- kryejne regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e Shoqërisë pranë Qendres Kombëtare e Biznesit, kur është e nevojshme;
- (vi) raportimin përpara Asamblesë/Ortakut të Vetëm, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - (vii) kryerjen e detyrave të tjera të caktuara në ligj dhe nga Asambleja/Ortaku i Vetëm.


16.2. Administratori(et) mbikëqyrin dhe sigurojnë që zyrtaret, agjentët, të punësuarit, auditorët dhe këshilltarët e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqërisë. Administratori(et) duhet të raportojnë tek Ortaku në lidhje me personat të cilët emerohen nga Ortaku.

Neni 17

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

17.1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nenëve 14,15,16,17 e 18 të Ligjit të Shoqërisë, administratorët detyrohen:

- (i) të kryejnë detyrat e tyre e përcaktuara në ligj ose në këtë Statut në mënyrë të mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në teresi, duke i kushtuar vëmendje të vecante ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- (ii) të ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë dispozitë;
- (iii) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- (iv) të parandalojnë dhe menjagojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;



(v) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

17.2. Administratorët pergjigjen kundrejt shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.

17.3. Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.

17.4. Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundershitim me Ligjin per Shoqerite kryen veprimet e meposhtme:

(i) i kthen Ortakeve kontributet;

(ii) i paguan Ortakeve interesa apo dividente;

(iii) i shperndan asetet Shoqerise;

(iv) lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitein e saj, kur duhet ta kishite parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishite afresi paguese per te shlyer detyrimet e saj;

(v) jep hua;

KREU VI **Administrimi Financiar i Shoqerise**

Neni 18 **Eksperti Kontabel i Autorizuar**



18.1 Ortaku cakton ekspertin kontabel te autorizuar (audites) per te dhene sherbimet e tij kundrejt Shoqerise.

18.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII **Aktiviteti Shoqerise**

Neni 19 **Viti ekonomiko-financiar**

19.1. Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-t te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.



Neni 20
Mbajtja e Llogarive

20.1. Shoqeria do te mbajje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

Neni 21
Llogaritja dhe Shperndarja e Firimt

21.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te pasqyrave financiare te aprovuar nga Asambleja/Ortaku i Vetem. Cdo ndryshim ne destinacionin e fitimit do te caktohet nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne perputhje me Statutin dhe me ligjet e zbatueshme.

21.2. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje firimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

(i) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;

(ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem;

21.3. Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.2 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush kerkesat sipas 21.2, Administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

21.4. Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

KREU VIII
Modifikimi i Formes Lgjore dhe Prishja

Neni 22
Modifikimi i Formes Lgjore


22.1. Forma lgjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

22.2. Shoqeria do te permbushe te gjitha procedurat lgjore te regjistrimit te nevojshme ne Shqiperi per kete qellim.

Neni 23
Prishja e Shoqerise

23.1. Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e meposhtme:

(i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;



- (ii) me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem;
- (iii) me hapjen e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne cdo kohe.

23.2. Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

KREU IX Te ndryshme

Neni 24
Largimi i Ortakut

24.1. Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 te Ligjit per Shoqerite Tregtare.

Neni 25
Te tjera

25.1. Cdo ceshtje tjetere, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

Ortaket e Shoqerise

FOOTBALL REPUBLIC SHPK

Z. Fedri Jupi

Zi.....

